



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 36, datë 7.04.2020

“PËR

NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 15, DATË 10.03.2004, TË KËSHILLIT BASHKIAK “PËR STRUKTURËN ORGANIZATIVE DHE NIVELIN E PAGAVE TË DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË OBJEKTEVE PUBLIKE”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nën-pika 1.1, shkronja “b” dhe “ç”, nenit 29, pika 1, nenit 54, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, nenit 15, të Ligjit nr.15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive” të ndryshuar, nenit 27, pika “c”, nenit 30, pika “f”, nenit 42, të Ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, pikës 6.2, shkronja “a” të Vendimit nr. 243, datë 24.3.2020 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

Në vendimin nr. 15, datë 10.03.2004 të Këshillit Bashkiak “Për strukturën organizative dhe nivelin e pagave të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Pas pikës 1/1, shtohet pika 1/2, me përmbajtjen si më poshtë:

1.2 “ Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, në kuadër të marrjes së masave për garantimin dhe rritjen e sigurisë së shtetasve për përballimin e fatkeqësisë natyrore për shkak të epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, të realizoj procesin e dezinfektimit në territorin e Bashkisë Tiranë.”.

2. Në zbatim të këtij vendimi, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike koordinon me strukturat përgjegjëse të shërbimit shëndetësor për përcaktimin e zonave për dezinfektim në Bashkinë Tiranë.

3. Shpenzimet financiare sipas këtij vendimi do të përballohen duke pakësuar fondin e emergjencave civile të miratuar në buxhetin e Bashkisë Tiranë për vitin 2020, art 606 në vlerën 27.800.000 lekë dhe duke shtuar shpenzimet operative (art.602) në vlerën 25.000.000 lekë dhe shpenzimet kapitale (art.231), për blerje pajisje dezinfektimi në vlerën 2.800.000 lekë, të Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike në buxhetin e vitit 2020.

4. Ky vendim ka karakter të përkohshëm dhe zbatohet për aq kohë sa zgjat periudha e infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.

5. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit financiar për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

